

AXHENDA
MBLEDHJE XXXV
KËSHILLI I INVESTIMEVE

AKSESI NË FINANCË
MBI PËRMIRËSIMIN E INSTRUMENTAVE FINANCUES

Data: 12 Nëntor 2024

11h00 – 12h30

Vendi: Salla Ovale, Pallati i Kongreseve

11:00 – 11:10 | Mirëseardhje dhe Miratimi i Agjendës

Z. Blendi Gonxhja, Kryetar i KI / Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

11:10 – 11:20 | Prezantim mbi Aksesin në Financa për Ndërmarrjet e Vogla, të Mesme dhe të Mikro (MSME) dhe Rekomandime për Përmirësimin e Instrumenteve të Financimit
Prezantuar nga: Sekretariati i Këshillit të Investimeve

11:20 – 12:20 | Diskutim i Fokusuar nga Anëtarët e KI

Seanca do të trajtojë sfidat kryesore me të cilat përballen ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Shqipëri, duke theksuar rëndësinë e aksesit në financë për rritjen ekonomike dhe avancimin e sipërmarrjes. Pikat e diskutimit përfshijnë:

1. Sfidat në Financimin për NMVM-të:

- Kërkesa të larta për kolateral
- Histori e kufizuar krediti
- Kushte të kufizuara të kredive dhe kosto të larta administrative
- Procedura të gjata dhe burokratike
- Njohuri financiare të kufizuara tek NMVM-të

A mund të marrin bankat, duke pasur pozicione të forta kapitale, më shumë rreziqe për të mbështetur NMVM -të?

2. Edukimi Financiar:

- Nevoja për të forcuar kapacitetet financiare të NMVM-ve për të kuptuar më mirë produktet financiare dhe menaxhimin financiar.
- Përfshirja e programeve të trajnimit dhe burimeve edukative për rritjen e njohurive financiare ndërmjet ndërmarrjeve.

3. Harmonizimi i Përkufizimeve për Rritjen e Cilësisë së të Dhënave:

- Nxitja e harmonizimit të përkufizimeve të përdorura nga bankat dhe institucionet financiare për klasifikimin e NMVM-ve dhe produkteve financiare.
- Përmirësimi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave për të mundësuar vendimmarrje më të informuar dhe efektive në politikëbërje.

4. Digjitalizimi në Shërbimet Bankare:

- Digjitalizimi ka përmirësuar shërbimet, por shumë banka ende përballen me vonesa në vlerësimin e kredive.
- Potenciali i automatizimit për të përmirësuar proceset e transaksioneve, vlerësimin e riskut, përputhjen me rregulloret dhe verifikimin e dokumenteve.
- Konsiderimi i aksesit për institucionet financiare në databazat shtetërore (nëpërmjet AKSHI-t): përfitimet dhe rreziqet e përfshira.

5. Skemat e Garantimit të Kredive të Pjesshme:

- Rritja e atraktivitetit të këtyre skemave për bankat dhe institucionet mikrofinanciare për të përmirësuar përdorimin e tyre.
- Mbështetja e targetuar për bizneset e drejtuara nga gratë.
- Vlerësim i rregullt i ndikimit dhe strategji adaptative për të siguruar efektivitetin e vazhdueshëm.

6. Politika Shtesë dhe Rregullime Legjislative:

- Identifikimi i nevojave të mëtejshme për politika dhe rregullore për të mbështetur më mirë aksesin në financë.

12:20 – 12:30 | Miratimi i Rekomandimeve dhe Fjalët e Mbylljes

Z. Blendi Gonxhja, Kryetar i KI / Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit